



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-10960

Me datë: 04.03.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 e lidhur me nenin 62, pika 1 të ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008", nenin 44 të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Kryetari i Komunës në Suharekë, merrë këtë:

V E N D I M

Për formimin e grupit punues

- I. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për përgaditjen e planit të veprimit dhe rishikimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në Raportin Final të Auditimit, për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2025 të Zyrës Kombëtare të Auditimit, konform procedurës standarde të operimit – trajtimi i të gjeturave dhe zbatimit të rekomandimeve të miratuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve. Për anëtarë të Grupit Punues caktohen:
- 1.1 Erza Ramadani.....koordinatore
1.2 Armend Krasniqi.....anëtarë
1.3 Florinda Isufaj.....anëtare
1.4 Atthe Buzhala.....anëtarë
1.5 Donika Hajdari.....anëtare
1.6 Fisnik Shala.....anëtarë
1.7 Agim Bylygbashi.....anëtarë
- II. Detyrë e Koordinatorës (e cila është edhe kryesuese e grupit punues) dhe anëtarëve të Grupit Punues, në bashkëpunim me NjAB është që të bëjë përpilimin e planit të veprimit për Raportin Final të Auditimit, për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2025 të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
- III. Ky Grup Punues njëkohësisht është i obliguar që të përgadit raporte individuale për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe t'i raportojnë Koordinatorit të procesit auditues, i cili në bashkëpunim me NjAB, përgadit dhe shqyrton raportin e progresit, i cili i dorëzohet Kryetarit të Komunës dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, në dy periudha: 15 Mars 2026 dhe 30 Shtator 2026, ashtu siç e parasheh pika 5 e nenit 14 e Rregullores së Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit të miratuar nga Auditori i Përgjithshëm (ZKA).
- IV. Obligohet Koordinatori dhe anëtarët e Grupit Punues për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Koordinatorës;
- Grupit Punues;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Bali Muharremaj

